

## VETINGU DHE INTEGRITETI

### TREGUESIT E VETINGUT DHE INTEGRITETIT TË ZYRTARËVE TË LARTË NË KONTEKSTIN E REFORMËS NË DREJTËSI 2016-2026

*Raport Analitik<sup>1</sup>*

#### Hyrje

Promovimi i shtetit të së drejtës (RoL) në demokracitë në tranzicion shpesh është formësuar nga ajo që mund të përshkruhet si një “*paradigmë e rreme*” - një kornizë konceptuale dhe politike që supozon se modelet perëndimore të qeverisjes mund të transplantohen në mënyrë universale, pavarësisht konteksteve historike, kulturore dhe institucionale të vendit përfitues. Termi “*paradigmë e rreme*” e ka origjinën në ekonominë e zhvillimit, ku është përdorur për të kritikuar dështimin e strategjive të zhvillimit në Jugun Global. Këto strategji, shpesh të hartuara nga ekonomistë perëndimorë dhe organizata ndërkombëtare, janë bazuar në një kuptim të pasaktë të faktorëve që nxisin zhvillimin. Për shembull, ato shpesh mbivlerësojnë akumulimin e kapitalit duke neglizhuar rëndësinë kritike të strukturave shoqërore dhe transformimit institucional (Weeks, 2012).

Në kontekstin e reformave të shtetit të së drejtës, kjo paradigmë manifestohet përmes përpjekjeve të nxitura nga donatorët që prioritetizojnë aspektet formale të inxhinierisë ligjore dhe kushtetuese, si pavarësia e gjyqësorit, mekanizmat e transparencës dhe kundër korrupsionit, ndërkohë që u kushtohet vëmendje e pamjaftueshme dinamikave politike vendase, institucioneve informale dhe normave shoqërore. Megjithatë modelet e zhvillimit të

---

<sup>1</sup> Në kuadër të projektit “*Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur*” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

promovuara nga organizatat ndërkombëtare perëndimore nuk janë në vetvete të gabuara dhe shpesh ofrojnë udhëzime teknik dhe normativ të vlefshëm, efektiviteti i tyre zvogëlohet ndjeshëm kur pronësia vendase, legjitimiteti dhe përshtatshmëria ndaj kontekstit injorohen. Që nismat për shtetin e së drejtës të kenë sukses, ato duhet të jenë të ndjeshme ndaj kompleksiteteve të ekosistemeve vendase të qeverisjes dhe të kalibrohen për të mbështetur procese endogjene të zhvillimit ligjor dhe institucional (Klabbers, 2015).

Studiues si Mendelski (2015) e kanë kritikuar këtë qasje, duke argumentuar se ajo priorizon përputhshmërinë teknike mbi transformimin sistematik, duke prodhuar shpesh reforma sipërfaqësore që nuk arrijnë të çmontojnë dinamikën e rrënjësore të pushtetit informal ose të ndërtojnë legjitimitet institucional të qëndrueshëm. Mendelski thekson se reformat e shtetit të së drejtës të eksportuara përmes ndihmës për zhvillim kanë tendencë të theksojnë transplantet ligjore, duke prodhuar reforma të *“izomorfizmit organizativ”* që duken efektive në letër, por dështojnë në praktikë për shkak të mungesës së përshtatjes kontekstuale (Mendelski, 2015).

Reforma gjyqësore e Shqipërisë e vitit 2016, e konsideruar gjerësisht si një iniciativë historike në Ballkanin Perëndimor, mishëron këtë tension midis projektimit ndërkombëtar dhe zbatimit të brendshëm (Komisioni Evropian, 2024). Nga njëra anë, ajo u katalizua nga kushtëzimi i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), kryesisht përmes Kapitujve 23 dhe 24 të *acquis communautaire*, që lidhen me reformën në drejtësi dhe të drejtat themelore, dhe u përforcua nga presioni diplomatik i nivelit të lartë nga Shtetet e Bashkuara, kryesisht përmes Ambasadës së SHBA-së në Tiranë dhe USAID/OPDAT (Nela, 2021). Nga ana tjetër, reforma zbuloi paradoksin në zemër të proceseve të reformave të nxitura nga jashtë: *ndërsa organizatat ndërkombëtare ofruan një levë të domosdoshme për të kapërcyer rezistencën politike të rrënjësore dhe mosfunksionimin institucional, legjitimiteti dhe qëndrueshmëria afatgjatë e reformës mbeten të kontestuara.*

Janë shfaqur shqetësime për tejkalimin teknokratik, strategjitë e elitave për përputhje performative dhe skepticizmin shoqëror ndaj agjendave të nxitura nga jashtë, veçanërisht në një vend me histori të gjatë ndërhyrjeje të huaj (Feta & Rruplli, 2025).

Trajektorja politike dhe ligjore e Shqipërisë përbën një rast studimor domethënës për ndërveprimin midis ndikimit ndërkombëtar dhe dinamikave të reformës së brendshme. Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, Shqipëria nisi një proces të zgjatur dhe shpesh të pabarabartë demokratizimi. Kushtetuta e vitit 1998 ishte një moment kyç në formalizimin e ndarjes së pushteteve dhe garantimin e pavarësisë së gjyqësorit. Megjithatë, gjyqësori post-komunist mbeti i karakterizuar nga politizimi, korrupsioni i përhapur dhe mungesa e standardeve profesionale.

Qysh në vitet 2000, programet e financuara nga BE-ja dhe SHBA-ja u përpoqën të forconin shtetin e së drejtës në Shqipëri përmes trajnimeve, investimeve në infrastrukturë dhe harmonizimit ligjor. Megjithatë, besimi publik në drejtësi mbeti i ulët, me sondazhe që

tregojnë se shumica e qytetarëve i konsiderojnë gjykatat si të korruptuara dhe të varura nga interesat politike dhe ekonomike (Transparency International, 2016; Freedom House, 2017).

Nga mesi i viteve 2010, presioni për reformë arriti një pikë kritike. Bashkimi Evropian e bëri reformën në drejtësi një test për avancimin e integritit, ndërsa Shtetet e Bashkuara e konsideruan disfunktionimin e drejtësisë si pengesë për konsolidimin demokratik dhe si faktor risku për krimin e organizuar. Këto presione çuan në miratimin e paketës së reformës në vitin 2016, e cila përfshinte ndryshime kushtetuese dhe ligjore që ristrukturuan sistemin gjyqësor.

Në qendër të reformës ishte procesi i vettingut: një rivlerësim sistematik i gjyqtarëve dhe prokurorëve në aspektin profesional dhe etik. I mbikëqyrur nga institucionet përkatëse dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, procesi synonte largimin e elementëve të korruptuar, të paaftë ose të komprometuar politikisht.

Konteksti politik i reformës ishte i polarizuar, me tensione të forta dhe kriza politike, përfshirë bojkotin parlamentar të opozitës dhe ndërhyrjen ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës. Në të njëjtën kohë, raste të profilit të lartë të korrupsionit rritën skepticizmin publik mbi vullnetin real politik për luftimin e pandëshkueshmërisë.

Procesi i vettingut çoi në shkarkimin ose dorëheqjen e më shumë se 60% të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke krijuar pasoja të rëndësishme për funksionimin e sistemit dhe duke rritur stokun e çështjeve të pazgjidhura.

## **Metodologjia**

Ky studim përdor një metodologji cilësore të tipit studim rasti, duke përdorur metodën e ndjekjes së procesit (process tracing) për të gjurmuar sekuencën e ndryshimeve kushtetuese të Shqipërisë në vitin 2016 deri te rezultatet e vettingut në periudhën 2018–2023. Materialet primare, përfshirë amendamentin kushtetues përkatës dhe ligjet zbatuese, raportet zyrtare të zgjerimit të Komisionit Evropian, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe deklaratat nga misionet e OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, janë analizuar së bashku me burime dytësore si Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i Transparency International, vlerësimet e Freedom House dhe kritikant akademike mbi reformat e shtetit të së drejtës të nxitura nga jashtë.

Përmes kodimit tematik dhe triangulimit të burimeve, analiza identifikon mënyrën se si kushtëzimi i Bashkimit Evropian dhe presioni diplomatik i Shteteve të Bashkuara ndikuan në veprimin legjislativ, në ngritjen e organeve mbikëqyrëse dhe në modelet e shkarkimit të gjyqtarëve. Duke marrë parasysh se të dhënat publike nuk mund të pasqyrojnë plotësisht negociatat informale, studimi rekomandon zhvillimin e intervistave të synuara me aktorë kyç në kërkime të ardhshme.

## Roli i organizatave ndërkombëtare si sipërmarrëse normash dhe ndikuese strukturore

Organizatave ndërkombëtare funksionojnë si sipërmarrëse normash duke promovuar korniza të shtetit të së drejtës të bazuara në idealet perëndimore të demokracisë liberale, shpesh duke i paraqitur ato si parakushte universale për zhvillim dhe stabilitet. Megjithatë, kjo qasje përjetëson një *“paradigmë të rreme”*, e mbështetur në teorinë e varësisë dhe në studimet post-koloniale, duke i dhënë përparësi mimikës institucionale mbi përshtatjen kontekstuale dhe duke thelluar pabarazitë strukturore dhe deficitin e legjitimitetit.

Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe organizata të tjera ndërkombëtare përhapin norma përmes programeve të asistencës teknike që transplantojnë modele të standardizuara institucionale në kontekste socio-politike të ndryshme. Roli i BE-së në Shqipëri përbën një shembull të kësaj qasjeje. Përmes programeve si EURALIUS IV, BE-ja ofroi ekspertizë mbi pavarësinë e gjyqësorit, kuadrot kundër korrupsionit dhe dizajnin institucional, duke reflektuar strategjinë e saj më të gjerë të *“evropianizimit”* të strukturave të qeverisjes së vendeve candidate.

Në mënyrë të ngjashme, USAID dhe OPDAT mbështetën trajnimin e prokurorëve dhe hartimin e legjislacionit, duke i paraqitur këto ndërhyrje si rrugë drejt sistemeve moderne të drejtësisë. Megjithatë, këto ndërhyrje nuk janë neutrale dhe reflektojnë modele normative të demokracisë liberale perëndimore, duke e paraqitur centralizimin gjyqësor, transparencën dhe meritokracinë si norma universale.

Në praktikë, këto modele shpesh janë përplasur me realitetet vendase në Shqipëri, ku rrjetet informale të patronazhit kanë ndikuar në emërimet në drejtësi. Zbatimi i vonuar i Këshillit të Lartë Gjyqësor krijoi hapësirë për ndërhyrje politike në emërimet e përkohshme, duke minuar pavarësinë e institucionit që në fazat fillestare. Në të njëjtën kohë, SPAK, i modeluar mbi strukturat italiane kundër mafias, ka treguar rezultate premtuese në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, megjithëse ndikimi politik në çështjet e korrupsionit mbetet një shqetësim i vazhdueshëm.

Kushtëzimi i BE-së ka luajtur një rol thelbësor në nxitjen e reformave, duke lidhur ndihmën financiare dhe progresin drejt anëtarësimit me përmbushjen e standardeve të caktuara. Ky presion ka kontribuar në kapërcimin e ngërçit politik dhe në miratimin e reformave kushtetuese dhe ligjore. Megjithatë, ai ka nxitur edhe përputhje formale, ku reformat zbatohen në letër, por nuk shoqërohen me zbatim efektiv në praktikë.

Mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit, përfshirë Komisionin e Venecias, OSBE-në dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, kanë luajtur një rol në forcimin e transparencës dhe legjitimitetit procedural. Megjithatë, këta mekanizma përforcojnë gjithashtu asimetritë

strukture, ku organizatat ndërkombëtare dhe shtetet donatore ndikojnë në përcaktimin e agjendës së reformave, shpesh në përputhje me interesat gjeopolitike.

### **Arkitektura dhe fazat e reformës gjyqësore të vitit 2016**

Reforma gjyqësore e Shqipërisë e vitit 2016 u zhvillua përmes një serie ndryshimesh kushtetuese, miratimesh legislative, krijimesh institucionesh dhe fazash zbatimi, secila e ndikuar nga presioni i jashtëm i vazhdueshëm dhe negociatat e brendshme politike. Procesi filloi në tetor 2016 me Amendamentin nr. 76/2016 të Kushtetutës, i cili sanksionoi për herë të parë parimin e rivlerësimit kalimtar (vettingut) për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Duke përfshirë Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (IMO) në aneksin kushtetues, elita politike shqiptare sinjalizoi se mekanizmat vendas konsideroheshin të pamjaftueshëm për të garantuar paanshmërinë dhe integritetin në gjyqësor. Në muajt në vijim, Kuvendi miratoi tre ligje kyçe. Ligji nr. 84/2016 përcaktoi bazat dhe procedurat për vettingun, të cilat përfshijnë verifikimin e pasurisë dhe kontrollin e së kaluarës penale. Ligji nr. 111/2016 krijoi Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH) për të trajtuar korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar. Së fundi, Ligji nr. 115/2016 ristrukturoi Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), duke u dhënë atyre autoritet mbi emërimet, promovimet dhe mbikëqyrjen disiplinore.

Faza operationale filloi në mesin e vitit 2017 pas një vonese disa mujore të shkaktuar nga bojkotet e opozitës dhe një referim në Gjykatën Kushtetuese. Në bazë të një marrëveshjeje BE–SHBA të majit 2017, të ndërmjetësuar nga Federica Mogherini dhe Hoyt Brian Yee, organet e vettingut: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe organi mbështetës i tij, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), u krijuan më në fund. Këto organe kombinuan nëntë profesionistë ligjorë vendas me gjashtë ekspertë ndërkombëtarë të nominuar nga BE, OSBE dhe Këshilli i Evropës. Në të njëjtën kohë, IMO, i drejtuar nga G.R-C., siguroi mbikëqyrje të jashtme të seancave, vlerësimit të provave dhe raportimit publik (European Western Balkans, 2017). Përbërja e përzier e këtyre paneleve synonte të ndërthurte ekspertizën ligjore vendase me standardet ndërkombëtare, megjithatë ajo gjithashtu nxiti shqetësime të brendshme mbi sovranitetin dhe keqkuptimet kulturore.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), organi i nivelit të parë i vettingut në Shqipëri për gjyqtarët dhe prokurorët, përfundoi zyrtarisht mandatin e tij shtatëvjeçar pasi vlerësoi 805 magistratë. Që nga 1 janari 2025, të gjitha çështjet e pazgjidhura të mbikëqyrura më parë nga Komisionerët Publikë do të transferohen në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e drejtuar në atë kohë nga A.D.. Procesi i vettingut ka qenë një gur themeli i reformës në drejtësi në Shqipëri, me synim rivendosjen e besimit publik përmes vlerësimit të kualifikimeve profesionale, integritetit moral dhe sfondit financiar të zyrtarëve të drejtësisë. Nga ata që u vlerësuan, 268 magistratë u shkarkuan, ndërsa rreth 100 dhanë

dorëheqje paraprakisht, duke parashikuar se nuk do të përmbushnin kriteret. Megjithëse konsiderohet gjerësisht si një sukses nga partnerët ndërkombëtarë, përfshirë Bashkimin Evropian, reforma është përballur me rezistencë politike të brendshme (Albanian Times, 2024).

Njëkohësisht, SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) nisën hetime mbi raste të korrupsionit të profilit të lartë që përfshinin ish-ministra, ish-president, kryetarë bashkish, parlamentarë dhe figura të fuqishme të biznesit, duke sfiduar pandëshkueshmërinë e rrënjësorë prej kohësh. Misioni i SPAK për të luftuar korrupsionin dhe pandëshkueshmërinë ende gëzon mbështetje të gjerë publike. Shqiptarët kanë kërkuar prej kohësh drejtësi, dhe kur figura të profilit të lartë që për një kohë të gjatë konsideroheshin të paprekshme filluan të përballeshin me hetime, u krijuan një ndjenjë llogaridhënieje të shumëpritur. Megjithatë, me kalimin e kohës, krahas zhvillimeve pozitive, filloi të shfaqej një model shqetësues akuzash, histori për konfiskime arbitrare të telefonave, taktika agresive, madje detyruese të marrjes në pyetje, dhe një atmosferë më e gjerë frike që sillte jehona të pakëndshme të periudhave të errëta që shqiptarët kishin filluar t'i harronin (Albanian Times, 2025). Evolucionin e SPAK nga një institucion i sapokrijuar në një strukturë të aftë për të përballur elitën politike sinjalizon një ndryshim të paprecedentë në peizazhin e shtetit të së drejtës në Shqipëri. Siç thekson Gunjic (2022), kjo fazë e reformës reflekton njëkohësisht potencialin transformues të institucioneve të mbështetura ndërkombëtarisht dhe sfidat e vazhdueshme të institucionalizimit të praktikave gjyqësore të paanshme në një mjedis politik të polarizuar.

### **Analiza: Pajtimi i presioneve të jashtme me realitetet e brendshme**

Përballja e vazhdueshme e Shqipërisë me korrupsionin është thellësisht e rrënjësorë në të kaluarën e saj autoritare dhe në tranzicionin e papërfunduar drejt qeverisjes demokratike. Nën regjimin komunist të Enver Hoxhës (1944–1985), gjyqësori funksiononte si një mjet i Partisë së Punës, duke i dhënë përparësi konformitetit ideologjik mbi autonominë ligjore. Gjyqtarët emëroheshin për të ruajtur kontrollin shtetëror dhe për të shtypur kundërshtimin, duke rrënjësuar një kulturë ku shteti i së drejtës i shërbente pushtetit politik dhe jo llogaridhënies publike. Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, kjo trashëgimi vazhdoi. Kuadrot e dobëta institucionale dhe mungesa e mekanizmave gjithëpërfshirës të drejtësisë tranzitore lejuan që elitat e mëparshme komuniste dhe aktorët e rinj politikë të kapnin gjyqësorin, duke përforcuar ndikimin e elitave dhe pandëshkueshmërinë ligjore (Kasmi 2024).

Joefikasiteti gjyqësor e përkeqësoi më tej problemin e korrupsionit. Mosmarrëveshjet civile, veçanërisht çështjet që lidhen me pronën, zakonisht kërkonin 8–10 vite për t'u zgjidhur, ndërsa vonesat administrative pengonin zhvillimin ekonomik. Qytetarët, të zhgënjyer nga sistemi formal i drejtësisë, iu drejtuan alternativave informale: komunitetet rurale shpesh mbështeteshin në të drejtën zakonore të bazuar në kanun, ndërsa banorët e zonave urbane gjithnjë e më shumë përfshiheshin në ryshfet për të përshpejtuar vendimet gjyqësore. Këto

dinamika minuan ndjeshëm besimin publik në institucionet shtetërore dhe në shtetin e së drejtës (Joireman, 2014). Kolapsi i skemave piramidale në vitin 1997, i cili shkaktoi trazira të dhunshme dhe mbi 2,000 viktima, demonstroi në mënyrë të qartë brishtësinë e mbikëqyrjes shtetërore dhe kapjen e gjerë të institucioneve rregullatore (Beck, 1997).

Nisma e reformës në drejtësi e vitit 2016 shënoi një moment kthese, e katalizuar nga pakënaqësia në rritje e publikut dhe presioni intensiv ndërkombëtar. Ndërsa organizatat ndërkombëtare luajtën një rol të rëndësishëm në shtyrjen përpara të reformave që synonin çmontimin e kapjes së elitave, ato gjithashtu rrezikuan të minonin legjitimitetin kombëtar. Mekanizmi i kushtëzimit i Bashkimit Evropian, veçanërisht përmes Kapitujve 23 dhe 24 të *acquis communautaire*, funksionoi njëkohësisht si një standard teknik dhe një instrument politik. BE-ja lidhi drejtpërdrejt progresin në negociatat e anëtarësimit me miratimin e reformave të gjera kushtetuese dhe ligjore në vitin 2016, duke paralajmëruar se çdo vonesë do të *“rrezikonte vetë besueshmërinë e procesit”* (European Commission, 2016). Kjo u përforcua nga përfshirja e Shteteve të Bashkuara përmes USAID dhe OPDAT, si dhe veçanërisht nga Ambasadori D.L., i cili deklaroi se Shtetet e Bashkuara: *“Nëse kjo reformë dështon, ju, anëtarët e këtij komiteti, do të turpëroni popullin që ju ka zgjedhur. Dhe do të dëmtoni marrëdhënien tuaj me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian,”* (Erebara, 2016). Ky harmonizim i rrallë midis aktorëve ndërkombëtarë dhe atyre vendas mundësoi arritjen e konsensusit politik dhe hapësirën për veprim nga koalicionet reformuese.

Procesi i reformës filloi me Amendamentin Kushtetues nr. 76/2016, i cili prezantoi një sistem tranzitor vettingu për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Për të garantuar besueshmërinë, Shqipëria integroi Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (IMO), i përbërë nga ekspertë ligjorë ndërkombëtarë nga BE, OSBE dhe Këshilli i Evropës, në kuadrin kushtetues (Venice Commission, 2016). Kjo u pasua nga tre ligje kyçe:

- Ligji nr. 84/2016 për procesin e vettingut,
- Ligji nr. 111/2016 për krijimin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), dhe
- Ligji nr. 115/2016 për ristrukturimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

Pavarësisht vonesave të shkaktuara nga opozita politike dhe sfidat ligjore në Gjykatën Kushtetuese, procesi u nis përfundimisht në vitin 2017 përmes një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga BE dhe SHBA. Organet e vettingut, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), përbëheshin nga një përzierje profesionistësh vendas dhe ndërkombëtarë. IMO, i drejtuar nga G. R-C., ofroi mbikëqyrje dhe legjitimitet duke garantuar përputhjen me standardet e BE-së. Megjithatë, ky model nxiti debate mbi sovranitetin kombëtar dhe transplantimin e modeleve ligjore perëndimore në kontekste post-komuniste (Elbasani & Šabić, 2017).

Midis shkurtit 2018 dhe nëntorit 2023, procesi i vettingut në Shqipëri, një pjesë integrale e reformës në drejtësi të mbështetur nga BE, rezultoi në shkarkimin ose dorëheqjen e një numri

të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh. Sipas të dhënave të Open Data Albania, nga 702 individë të rivlerësuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), 152 (21.7%) u shkarkuan, përfshirë 92 gjyqtarë, 58 prokurorë dhe 2 ndihmës ligjorë. Përveç kësaj, 109 individë (15.5%) dhanë dorëheqjen gjatë procesit të vettingut, përfshirë 63 gjyqtarë, 28 prokurorë, 12 ndihmës ligjorë, 4 këshilltarë ligjorë dhe 2 inspektorë. Në total, 261 anëtarë të sistemit të drejtësisë ose u larguan ose u shkarkuan, duke demonstruar thellësinë e reformës (Open Data Albania, 2023). Të dhëna të mëtejshme nga European External Action Service (EEAS) tregojnë se deri më 21 tetor 2024, KPK kishte dhënë 267 vendime shkarkimi dhe kishte regjistruar 113 dorëheqje. Këto zhvillime pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Shqipërisë për të forcuar integritetin e gjyqësorit duke larguar zyrtarët e konsideruar të papërshtatshëm për shkak të korrupsionit, mungesës së profesionalizmit ose pasurisë së pajustificuar. Megjithatë procesi ka qenë destabilizues, ai konsiderohet thelbësor për rivendosjen e besimit publik dhe për përafrimin e sistemit gjyqësor shqiptar me standardet e BE-së (European External Action Service, 2024).

Paralelisht, SPAK dhe BKH nisën ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar. Disa ish-ministra dhe figura të rëndësishme të biznesit u akuzuan. Megjithatë, këto institucione u përballën me mungesa serioze burimesh dhe pengesa politike. Një shembull i qartë ishte refuzimi i Kuvendit në vitin 2017 për të autorizuar arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm S.T., pavarësisht provave të besueshme nga autoritetet italiane që e implikonin atë në trafik narkotikësh (BIRN, 2018). Episodet e tilla ngritën shqetësime për drejtësi selektive dhe ndërhyrje të vazhdueshme të elitave.

Ndërsa përfshirja ndërkombëtare arriti të çmontojë format e dukshme të kapjes së gjyqësorit, natyra teknokratike e reformës prodhoi pasoja të paqëllimshme. Reforma e mbështetur nga BE për "*hartën gjyqësore*" çoi në mbylljen e shumë gjykatave lokale, duke detyruar qytetarët në zonat rurale të udhëtojnë distanca të gjata për të aksesuar shërbime bazë juridike, duke thelluar pabarazitë sociale dhe rajonale (Kasmi 2023). Gjithashtu, raporti BTI 2024 për Shqipërinë vëren se deri në vitin 2022 ishte realizuar vettingu vetëm për gjysmën e 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve të synuar. Pavarësisht strukturave të reja institucionale, stoket e çështjeve mbeten të larta dhe ndjekjet penale të nivelit të lartë janë ende të rralla. Presioni politik dhe varësia buxhetore vazhdojnë të pengojnë autonominë e plotë të gjyqësorit (BTI, 2024).

### **Përfundime dhe implikime për politikën**

Reforma gjyqësore e Shqipërisë e vitit 2016 qëndron si një rast studimor kritik mbi kompleksitetet e promovimit të shtetit të së drejtës, duke ndriçuar njëkohësisht potencialin transformues dhe kufizimet e brendshme të nismave të nxitura nga jashtë. Organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara siguruan një levë të domosdoshme për të çmontuar dekada të tëra korrupsioni të institucionalizuar, megjithatë rezultatet e kontestuara të reformës nënvizojnë domosdoshmërinë e pajtimit të normave të

jashtme me realitetet unike socio-politike të Shqipërisë. Zbatimi i reformës nxori në pah sfida të rrënjosura thellë: kriza kapacitetesh të shkaktuara nga shkarkimet e shpejta, kundërpërgjigje politike që penguan në mënyrë selektive ndjekjet penale të profilit të lartë, skepticizëm i vazhdueshëm publik i ushqyer nga perceptimet për imponim të huaj, si dhe përshtatja e rrjeteve të patronazhit ndaj formave të reja institucionale. Kjo përvojë demonstroi se zhvillimi i qëndrueshëm i shtetit të së drejtës kërkon korniza hibride që balancojnë llogaridhënien ndërkombëtare me veprimin vendas, duke kaluar përtej *“paradigmës së rreme”* të mimikës institucionale drejt një qeverisjeje adaptive dhe të ndjeshme ndaj kontekstit.

Arritjet e reformës, veçanërisht shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar përmes një mekanizmi vettingu të sanksionuar në Kushtetutë, krijimi i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe rikonstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nxjerrin në pah rolin katalitik të presionit të jashtëm në kapërcimin e ngërçeve politike. Aktakuzat e profilit të lartë të SPAK sinjalizuan një largim nga pandëshkueshmëria, por u penguan nga nënfinancimi kronik dhe pengesat politike, duke ilustruar se si dizajnet formale institucionale mund të dështojnë pa mbështetjet qëndrueshme vendase dhe angazhim burimesh. Megjithatë, këto arritje bashkëtojnë me kontradikta të theksuara. Mekanizmat e përzier të mbikëqyrjes vendase dhe ndërkombëtare, të konceptuar për të garantuar paanshmëri, në mënyrë të paqëllimshme ushqyen perceptime për imponim të huaj.

Pajtimi i normave të jashtme me realitetet kontekstuale kërkon përqafimin e hibritetit. Kalimi gradual i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit nga mbikëqyrja e drejtpërdrejtë drejt rolit të mentorimit, duke trajnuar vlerësues shqiptarë për të udhëhequr proceset e vettingut, ofron një model të mundshëm për transferimin e pronësisë duke ruajtur njëkohësisht garancitë ndërkombëtare. Bashkëpunimi i SPAK me organizata vendase të shoqërisë civile për hetimin e korrupsionit të vogël kontribuon në ngushtimin e hendekut midis institucioneve formale dhe nevojave në terren. Integrimi i mekanizmave informalë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në strategjitë e drejtësisë në zonat rurale mund të rindërtojë besimin e komunitetit pa cenuar integritetin ligjor.

Në vijim, kuadri i kushtëzimit i Bashkimit Evropian duhet të evoluojë duke i dhënë përparësi treguesve të bazuar në rezultate, përkundërt përputhjes formale me lista kontrolli. Studiues si Carothers (2006) dhe Mendelski (2015) argumentojnë se promovimi i vërtetë i shtetit të së drejtës mbështetet në matjen e përvojave reale: uljen e periudhave të paraburgimit, akses të barabartë në drejtësi në zonat rurale dhe rritje të besimit publik; dhe jo vetëm në miratimin formal të legjislationit. Për Shqipërinë, kjo nënkupton kombinimin e vettingut me reforma sistemike: rritjen e pagave në gjyqësor për të kufizuar stimujt për ryshfet, decentralizimin e shërbimeve gjyqësore për të adresuar ndarjet urbane-rurale dhe garantimin e autonomisë së institucioneve si SPAK përmes mekanizmave të pavarur të financimit.

Në përfundim, reforma shqiptare konfirmon se promovimi i shtetit të së drejtës nuk mund të trajtohet në mënyrë të izoluar. Pastrimi i gjyqësorit, megjithëse thelbësor, duhet të

shoqërohet me reforma strukturore që synojnë incentivat dhe rrjetet që riprodhojnë korrupsionin. Duke vendosur në qendër legjitimitetin kontekstual dhe duke fuqizuar aktorët vendas, reformat e nxitura nga jashtë mund të tejkalojnë paradoksin e imponimit dhe të evoluojnë në një shtet të së drejtës të qëndrueshëm dhe të ndërtuar nga brenda. Rasti shqiptar shërben kështu njëkohësisht si një paralajmërim dhe si një thirrje për të rimenduar promovimin e shtetit të së drejtës si një proces dinamik dhe bashkëpunues, që respekton kompleksitetin e realiteteve lokale duke synuar njëkohësisht parimet universale të drejtësisë.

## Bibliografia

1. Albanian Times. (2024, December 17). *Albania's 'Vetting Commission' concludes after 7 years of judicial reform*. <https://albaniantimes.al/albanias-vetting-commission-concludes-after-7-years-of-judicial-reform/>
2. Albanian Times. (2025, February 13). *The Veliq case and Albania's justice reform at a crossroads: The need for checks and balances*. <https://albaniantimes.al/spak-veliq-arrest-justice-reform-albania/>
3. Austrian Development Agency. (2023, April 1). *IMO-III International Monitoring Operation – Phase III, EC funds*. <https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/imo-iii-international-monitoring-operation-phase-iii-ec-funds>
4. Bieber, F. (2015). *The Western Balkans and the EU: The Hour of Europe?* Central European University Press.
5. Bieber, F. (2020). Antagonistic EU conditionality: The challenge of deep reform in the Balkans. *Journal of Democracy*, 31(1), 40–51. <https://doi.org/10.1353/jod.2020.0003>
6. Bieber, F. (2020). The rise of authoritarianism in the Western Balkans. *Southeast European and Black Sea Studies*, 20(1), 1–15.
7. Börzel, T. A., & Schimmelfennig, F. (2017). Coming together or drifting apart? The EU's political integration capacity in Eastern Europe. *Journal of European Public Policy*, 24(2), 278–296. <https://doi.org/10.1080/13501763.2016.1265574>
8. Beck, E. (1997, January 29). Albania's collapsing pyramids could tip political balance. *The Wall Street Journal*. <https://www.wsj.com/articles/SB854490470762118000>
9. Carothers, T. (2003). *Promoting the rule of law abroad: The problem of knowledge* (Carnegie Working Paper No. 34). Carnegie Endowment for International Peace. <https://carnegieendowment.org/2003/01/28/promoting-rule-of-law-abroad-problem-of-knowledge-pub-1169>
10. Carothers, T. (Ed.). (2006). *Promoting the rule of law abroad: In search of knowledge*. Carnegie Endowment for International Peace. <https://carnegieendowment.org/research/2006/01/promoting-the-rule-of-law-abroad-in-search-of-knowledge?lang=en>
11. Carothers, T. (1998). The Rule of Law Revival. *Foreign Affairs*, 77(2), 95–106. <https://doi.org/10.2307/20048791>
12. Carothers, T., & de Gramont, D. (2013). *Development aid confronts politics: The almost revolution*. Carnegie Endowment for International Peace. <https://carnegieendowment.org/2013/04/16/development-aid-confronts-politics-almost-revolution-pub-51407>
13. Council of Europe. (2017). *The Venice Commission reports on Albania's judicial reform*. Council of Europe.
14. Council of Europe. (2022). *Report on judicial independence in North Macedonia*. <https://rm.coe.int/report-judicial-independence-nm/>
15. Elbasani, A. (2013). *Europeanization and democratization in the Western Balkans: Institutional compatibility and external pressure*. Routledge.
16. European Commission. (2016). *Consolidation of the Justice System in Albania* (IPA 2016/038717.4). [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/f14735d2-a1b6-4e90-9bf6-657251898f78\\_en?filename=ipa\\_2016-038717-4\\_consolidation\\_of\\_the\\_justice\\_system\\_in\\_albania.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/f14735d2-a1b6-4e90-9bf6-657251898f78_en?filename=ipa_2016-038717-4_consolidation_of_the_justice_system_in_albania.pdf)
17. European Commission. (2024, July 24). *2024 Rule of Law Report: Country chapter on the rule of law situation in Albania* (SWD (2024) 828 final). [https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925\\_en?filename=59\\_1\\_58088\\_coun\\_chap\\_albania\\_al.pdf](https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf)
18. European Commission. (2016). *2016 enlargement package: Albania*. European Commission. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2016-11/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2016-11/20161109_report_albania.pdf)
19. European Commission. (2016, November 9). *Key findings of the 2016 Report on Albania* (MEMO/16/3636). [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/memo\\_16\\_3636](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/memo_16_3636)
20. European Commission. (2023). *2023 enlargement package: Albania*. European Commission. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20Albania%20report.pdf)

21. European Union Council. (2022). *EU conditionality and accession prospects for Western Balkan countries*. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-11222-2022-INIT/en/pdf>
22. European External Action Service. (2024, October 21). *Overview of the activity of the vetting bodies until 21 October 2024*. Retrieved from [https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/overview-activity-vetting-bodies-until-21-october-2024\\_en](https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/overview-activity-vetting-bodies-until-21-october-2024_en)
23. European Western Balkans. (2017, July 18). *Calavera: Vetting of judges and prosecutors starts in September*. <https://europeanwesternbalkans.com/2017/07/18/calavera-vetting-judges-prosecutors-starts-september/>
24. Erebara, G. (2016, May 5). US and EU ambassadors warn Albania leaders about much-delayed justice reform. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2016/05/05/us-and-eu-ambassadors-warn-albania-leaders-about-much-delayed-justice-reform-05-05-2016-6/>
25. Erebara, G. (2018, May 28). *US ambassador fears courts 'pressure' in Tahiri case*. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2018/05/28/bribes-and-pressure-on-albania-former-minister-drug-case-us-ambassador-warns-05-27-2018-1/>
26. Elezi, G. (2017). *Establishing the rule of law after communism: A comparative approach*. *Polis Journal*. <https://uet.edu.al/polis/wp-content/uploads/2023/02/Establishing-the-rule-of-law-after-communism-a-comparative-approach.pdf>
27. Elbasani, A., & Šelo Šabić, S. (2017). Rule of law, corruption and democratic accountability in the course of EU enlargement. *Journal of European Public Policy*, 25(9), 1317-1335. <https://doi.org/10.2139/ssrn.3308095>
28. Feta, B., & Rrupli, Ç. (2025, February). *The journey of Albania's justice reform: Progress amidst ongoing implementation challenges* (ALGREE Thematic Paper No. 1). Hellenic Foundation for European & Foreign Policy (ELIAMEP). [https://www.eliamep.gr/wp-content/uploads/2025/02/ALGREE-Thematic-Paper-1\\_Final-1.pdf](https://www.eliamep.gr/wp-content/uploads/2025/02/ALGREE-Thematic-Paper-1_Final-1.pdf)
29. Freedom House. (2017). *Nations in Transit 2017: The false promise of populism*. Freedom House. [https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2017\\_booklet\\_FINAL\\_0.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2017_booklet_FINAL_0.pdf)
30. Freedom House. (2023). *Albania: Nations in Transit 2023 Country Report*. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2023>
31. Groenendijk, K. (2019). Judicial harmonization and rule of law challenges in Kosovo. *Journal of Comparative Law*, 54(2), 67–83.
32. Gunjic, I. (2022). *Albania's special courts against corruption and organised crime* (U4 Brief 2022:1). U4 Anti-Corruption Resource Centre. <https://www.u4.no/publications/albanias-special-courts-against-corruption-and-organised-crime.pdf>
33. Klabbers, J. (2015). The EJIL foreword: The transformation of international organizations law. *European Journal of International Law*, 26(1), 9–82. <https://doi.org/10.1093/ejil/chv009>
34. Kasmi, J. (2023). The role of the Supreme Judicial Council in judicial reform: Stress for independence and accountability. *Beder Journal of Humanities*, 12(3), 18. <https://doi.org/10.13140/RG.2.2.20874.44485>
35. Kasmi, J. (2024). Dealing with the past and the path to transitional justice: A comparative analysis of South Korea and Albania. *Asian Politics & Policy*. Advance online publication. <https://doi.org/10.1111/aspp.12727>
36. Krygier, M. (2004). False dichotomies, true perplexities, and the rule of law. In A. Sajó (Ed.), *Human rights with modesty: The problem of universalism* (pp. 271–294). Springer. [https://doi.org/10.1007/978-94-017-6172-7\\_12](https://doi.org/10.1007/978-94-017-6172-7_12)
37. Kelmendi, T., & Vurmo, G. (2024, December 12). *Riding the wave: How Albania can make the most of its EU moment*. European Council on Foreign Relations. <https://ecfr.eu/article/riding-the-wave-how-albania-can-make-the-most-of-its-eu-moment/>
38. Kmezić, M., & Bieber, F. (2017). *Justice in transition: Judicial reforms in the Western Balkans*. Palgrave Macmillan.
39. Kochenov, D. (2008). *EU enlargement and the failure of conditionality*. Kluwer Law International.
40. Joireman, S. F. (2014). *Aiming for certainty: The Kanun, blood feuds and the ascertainment of customary law*. *Political Science Faculty Publications*, 1055. <https://scholarship.richmond.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1055&context=polisci-faculty-publications>
41. Law no. 76/2016, "For some changes in the law no. 8417, date 21.10.1998, 'The Constitution of the Republic of Albania'", amended.

42. Law no. 84/2016, "For the transitional reevaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania"
43. Law no. 111/2016, "On the organization and functioning of institutions in the fight against corruption and organized crime"
44. Law no. 115/2016, "For the government bodies of justice system"
45. Magen, A., & Morlino, L. (2008). International actors, democratization, and the rule of law. *International Political Science Review*, 29(3), 291–311.
46. Mendelski, M. (2015). The EU's pathological power: The failure of external rule of law promotion in Southeastern Europe. *Southeastern Europe*, 39(3), 318–346. <https://doi.org/10.1163/18763332-03903003>
47. Mungiu-Pippidi, A., Johnston, M., & Krafchik, W. (2019). *Anti-corruption and the future of governance*. World Bank.
48. Nela, I. (2021). *Lessons learned from the justice reform in Albania* (ÖGfE Policy Brief No. 24'2021). Austrian Society for European Politics (ÖGfE). <https://www.oegfe.at/policy-briefs/lessons-learned-from-the-justice-reform-in-albania/?lang=en>
49. Obradović-Wochnik, J. (2018). Serbia's struggle for rule of law: Political and judicial interference. *Southeast European and Black Sea Studies*, 18(2), 145–159. <https://doi.org/10.1080/14683857.2018.1474542>
50. Open Data Albania. (2023, November 10). *Justice Reform: Number of Judges and Prosecutors Dismissed or Resigned as a Result of Vetting*. Retrieved from <https://ndiqparate.al/?p=20854&lang=en>
51. Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE). (2021). *Judicial reform and digitalization in North Macedonia*. <https://www.osce.org/files/f/documents/3/3/496357.pdf>
52. Pajo, M. (2016). Consequences of the totalitarian past on the Albanian post-communist society. *European Journal of Multidisciplinary Studies*, 3, 45–62.
53. Perry, V. (2019). Post-conflict judicial reforms in Bosnia-Herzegovina and Kosovo: Challenges and progress. *Conflict, Security & Development*, 19(4), 298–319. <https://doi.org/10.1080/14678802.2019.1643976>
54. Ruiz-Calavera, G. (2018). Cilësia para shpejtësisë në kryerjen e vettingut në Shqipëri [Quality over speed in Albania's vetting process]. *Deutsche Welle*. <http://www.dw.com/sq/genoveva-ruiz-calavera-cilësia-para-shpejtësisë-në-kryerjen-e-vettingut-në-shqipëri/a-41451181>
55. Schimmelfennig, F., & Sedelmeier, U. (2005). *The Europeanization of Central and Eastern Europe*. Cornell University Press.
56. Transparency International. (2016). *Corruption Perceptions Index 2016*. Transparency International. <https://www.transparency.org/en/cpi/2016>
57. Transparency International. (2021). *Corruption Perceptions Index 2021*. <https://www.transparency.org/en/cpi/2021>
58. Transparency International. (2023). *Corruption Perceptions Index 2023*. <https://www.transparency.org/en/cpi/2023>
59. Trimçev, F. (2020). Albania's judicial reform package: Successes and struggles. *European Politics and Society*, 21(3), 327–341. <https://doi.org/10.1080/23745118.2020.1762571>
60. U.S. Agency for International Development, Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance, and Training (USAID/OPDAT). (2017). *Technical assistance records*. U.S. Embassy.
61. U.S. Department of State. (2021, August). *Albania: FY 2020 country assistance fact sheet*. <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/08/Albania-FY-2020-Country-Assistance-Fact-Sheet.pdf>
62. U.S. Embassy Tirana. (2017). *Remarks by Ambassador Donald Lu at the launch of the campaign against organized crime*. U.S. Embassy.
63. Venice Commission. (2018, December 17). *Opinion on draft constitutional amendments enabling the vetting of politicians* (Opinion No. 942/2018, CDL-AD (2018)034). European Commission for Democracy through Law. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)034-e)
64. World Bank. (n.d.). *Worldwide Governance Indicators*. <http://info.worldbank.org/governance/wgi>
65. Weeks, J. (2012). *The irreconcilable inconsistencies of neoclassical macroeconomics: A false paradigm*. Routledge.
66. Westminster Foundation for Democracy. (2019). *Parliamentary boycotts in the Western Balkans: A challenge to institutional democracy*. <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/parliamentary-boycotts-western-balkans-challenge-institutional-democracy>

